



Npi – 01/65 datë: 24.02.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 24.02.2023 nxjerr këtë:

**E K S T R A K T**  
**PROCESVERBAL**

**I M B L E D H J E S Ë -II- T Ë K O M I T E T I T P Ë R P O L I T I K Ë D H E F I N A N C A**

E mbajtur më datën: 24.02.2023 (e premte) në ora 09:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Grejtalb Emini drejtori i DPUKGJ, z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar dhe , znj.Genta Mehmeti, asistente e Kryesuesit.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 25.01.2023,
2. Draft-Rregullore për Taksa, tarifa dhe Gjoha për vitin 2023 (pas diskutimit publik),
3. Raporti Periodik për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021,
4. Raport financiar për vitin 2022 - Pasqyrat financiare,
5. Draft-Rregullore për Punën e Kuvendit dhe Komiteteve,
6. Draft-Plani Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027 (Pas diskutimit publik),
7. Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për mbrojtje nga dhuna në Familje 2023-2025,
8. Draft – Plani Komunal për Integritet 2023-2027,
9. Propozim-Vendim për ndarjen e lokacionit për objektin e ngushëllimeve të lagjes Sahiti dhe Musolli në fshatin Pjetërshtic.
10. Rekomandim për Ministrinë e Financave për faljen e 100 euro për tatimpaguesit e komunës së Shtimes, për vitin 2023.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për rendin e ditës.

**\* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi rendin e ditës.**

**Pika 1**

**Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 25.01.2023**

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi, Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e KPF-së, e mbajtur më 25.01.2023.**

## Pika 2

### Draft-Rregullore për Taksa, tarifa dhe Gjoha për vitin 2023 (pas diskutimit publik)

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën ja dha Bujar Feratit.

**z.Bujar Ferati, ZKF;** Përshëndetje, diskutimi publik ka përfunduar para 1 muaji kështu që unë diçka më tepër nuk kam.

**z.Përparim Ramusa;** Përshëndetje, kjo pikë është shty për shkak të kërkesës së KRM “Pastërtia” njësia në Shtime. Unë propozojë që ta dërgojmë direkt në Kuvend. Kërkojmë që drejtori i DSHP-së dhe Besniku si anëtar i Bordit me na dhënë sqarime.

**z.Kadri Emini;** Përshëndetje, pajtoj me Përparimin ne kemi qenë për rritjen e çmimeve.

**znj.Adelina Beqaj;** Përshëndetje, unë kam dilemë sepse nuk po e di qysh po mbetet me kërkesën e KRM “Pastërtia”, sepse po diskutohet veçmas.

**z.Bujar Ferati, ZKF;** Bartës i diskutimit publik kemi qenë në si ZKF. Kërkesa ka qenë nga Kuvendi për DSHP-në dhe Besnikun me na dhënë sqarime. Unë nuk kam diçka tjetër.

**z.Përparim Ramusa;** Rregullorja është punë e Kuvendit, le të ndahet kjo. Ne jemi me diskutuar kërkesën, por ta votojmë Rregulloren e pastaj shohim. Për të ardhmen mendoj se duhet me Konstatua se sa janë implikimet buxhetore.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Unë jam i pajtimit që Rregulloren me e votuar por bashke me kërkesën e KRM “Pastërtisë”. Kompania ka kërkuar me u rritë vlera e kontratë për shërbimet që duhet mi krye pa Komunën. Duhet me u përcaktuar a dojmë me i rritë tarifat apo jo.

**z.Përparim Ramusa;** Propozojë që Rregullorja të kalojë në Kuvend me tarifat e vjetra, ndërsa kërkesa e Pastërtisë le të trajtohet e veçantë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2023, kështu si është tani. Ndërsa për mbledhjen e Kuvendit duhet të vjen Drejtoria për Shërbime Publike me një rekomandim të qartë në formë të shkruar, për sa i përket kërkesës të KRM “Pastërtia” Njësia në Shtime.**

## Pika 3

### Raporti Periodik për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën ja dha Bujar Feratit.

**z.Bujar Ferati, ZKF;** Unë do të jem i qartë dhe i shkurtë, sepse veç e kam të qartë, mbi bazën e pikave që janë trajtuar, dhe materialin e keni pranuar për këtë pikë. ( shih dokumentin). Në vazhdim ky ndaras e lexoi materialin në pikat kryesore. Raporti i auditimit kur të na vjen do ta shohim se cilat pika i kemi përmbyllë e cilat jo. Mund të kemi rekomandime të reja. Pjesën ligjore e kemi kryer.

**znj.Adelina Beqaj;** E shikova në dokument që 5 rekomandime u tha që janë në proces. Pyetja është deri ku jemi në proces?

**z.Bujar Ferati, ZKF;** Flitet për dy-tri të gjetura që janë te Tatimi në Pronë, janë disa të gjetura për 10 euro. Unë nuk kam prekur kurrë në dokument.

**z.Përparim Ramusa;** Çdo e gjetur e Auditorit duhet me u realizuar. Unë propozojë që ne me i rekomandua Kuvendit, ndërsa Kuvendi me i rekomandua Ekzekutivit që me i realizua të gjeturat e Auditorit.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Shkojmë me Rekomandim për Kuvendin që të gjeturat duhet të përmirësohen.

**\* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi që t’i rekomandoi Kuvendit miratimin e një rekomandimi për Ekzekutivin që të angazhohet maksimalisht për realizimin (përmirësimin) e të gjeturave nga Auditori i Përgjithshëm.**

## Pika 4

### Raport financiar për vitin 2022 - Pasqyrat financiare

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën ja dha Bujar Feratit.

**z.Bujar Ferati, ZKF;** Kemi një dallim në mes të Raportit dhe Pasqyrave Financiare. Te raporti është një dokument origjinal i pa ndryshueshëm të cilin ne vetëm duhet me e plotësuar me shifra. Bëhet

fjalë për shpenzimet në të gjitha Kategoritë. Te Pasqyrat Financiare e kemi obligim ligjor nga Ministria, dhe ne duhet të përgjigjemi, mirëpo është mirë me e njoftuar edhe Kuvendin. Për këtë me fol tërë ditën nuk mjafton. Mirë është me pa se cilat kanë qenë ngecjet.

**znj.Adelina Beqaj;** Unë e kam lexuar raportin por nuk kam arritur me e kuptuar krejt. Unë propozojë që të shkojmë në Kuvend pa Rekomandim.

**z.Përparim Ramusa;** Faleminderit për raportin, është mirë që e ka pru ZKF-ja këtë raport të detajuar. E përkrahu propozimin e Adelines, që ta kalojmë pa Rekomandim.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** A ka me u votuar në Kuvend ky dokument apo jo.

**z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar;** E kemi zyrën ligjore e cila duhet me shikuar bazën ligjore.

**z.Përparim Ramusa;** Unë mendojë që me dalë në Kuvend dhe me u debatuar.

**z.Kadri Emini;** Mirë është me na sqaruar, zyrtari ligjor për bazën ligjore.

**z.Lumni Amrushi;** E përkrahu mendimin e Bujarit. Ne kemi qenë nëpër krejt ato procese dhe i kemi kaluar, e ju Kryesues është mirë me pas një bashkëpunim me zyrtarin ligjorë, e jo me ardhur këtu në Kuvend e në vend që me sqaruar diçka ai po e bëni situatën edhe më konfuze. Pres që mos me pas këso dilemash në të ardhmën por zyrtari ligjor me i dhënë sqarimet e nevojshme.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Zyrtari Ligjor duhet me qenë prezent dhe me qenë i përgatitur për secilën pikë. Mirëpo sot qenka në Gjykatë.

**z.Përparim Ramusa;** Ideja është me qenë sa më transparent, është mirë që është sjellë një raport i tillë i detajuar e jo me qëllim që ai me u rivotuar.

**\* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi që për këtë pikë mos të ketë Rekomandim, por kërkon nga Zyrtari Ligjor që për mbledhjen e Kuvendit më 28.02.2023 të përgatit një sqarim për Kuvendin lidhur me këtë pikë, se a duhet të votohet kjo pikë në Kuvend apo jo?**

#### Pika 5

##### Draft-Rregullore për Punën e Kuvendit dhe Komiteteve

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën ja dha Adelina Beqaj , për një elaborim për këtë pikë.

**znj.Adelina Beqaj;** Sa i përket kësaj Rregullore kemi bërë shumë punë, edhe kemi shkuar nen për nen, e kemi aplikuar U.A dhe ligjet. Ka pas pika që unë nuk jam pajtuar, që do ti cekim në Kuvend. Propozimi ka qenë që Legjislativit me i dhënë më shumë kompetencë , unë kam propozuar te pyetjet për sa i përket diskutimit edhe për dy minuta shtesë.

**z.Përparim Ramusa;** E falënderoj Komisionin për punën. Pasi që ka me shkuar në diskutim publik unë propozojë që ti rekomandojmë Kuvendit, që ta qojë në diskutim publik.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Pajtohem që ti rekomandojmë Kuvendit që të shkojë në diskutim publik, dhe ta bëjmë një Rregullore të qëndrueshme.

**\* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Rregullore për Punën e Kuvendit dhe Komiteteve.**

#### Pika 6

##### Draft-Plani Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027 (Pas diskutimit publik)

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Përparim Ramusa;** Pajtohem me ty Kryesues që t'i rekomandojmë Kuvendit për miratim, por nuk po mundem me kuptuar qasjen e drejtorit kur flitet për Planin për menaxhimin të mbeturinave për 5 vite e ai nuk është prezent.

**\* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Draft-Planit Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027.**

#### Pika 7

##### Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për mbrojtje nga dhuna në Familje 2023-2025

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Strategjinë dhe Planin e Veprimit për mbrojtje nga dhuna në Familje 2023-2025.**

Pika 8

Draft – Plani Komunal për Integritet 2023-2027

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**\* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft – Planin Komunal për Integritet për periudhën 2023-2027.**

Pika 9

Propozim-Vendim për ndarjen e lokacionit për objektin e ngushëllimeve të lagjes Sahiti dhe Musolli në fshatin Pjetërshtic

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Sqaroi se kemi edhe një rekomandim edhe të Bashkësisë Islame për nevojën e një objekti të tillë. DPUKGJ-ja e ka Rekomandimin që duhet me ja dhënë.

**z.Lumni Amrushi;** Unë vi nga ky fshat, e pashë në Gjeoportall që si lokacion është i përshtatshëm por për pjesën ligjore e ka drejtorja. Është pozicion i mirë për atë destinim që është kërkuar. Vota ime është “Për”.

**znj.Adelina Beqaj;** A është harmonia në mes banorëve dhe lagjeve, a e kemi edhe Rekomandimin e drejtorisë, kështu që unë e përkrahi këtë kërkesë.

**z.Përparim Ramusa;** Edhe unë e përkrahu , nuk kemi arsye mos me përkrah, sqarimet janë dhënë.

**z.Kadri Emini;** Edhe ne jemi “Për” pasi edhe KBI-a në Shtime ka dhënë pëlqim.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve.

**\* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndarjen e lokacionit për objektin e ngushëllimeve të lagjes Sahiti dhe Musolli në fshatin Pjetërshtic.**

Pika 10

Rekomandim për Ministrinë e Financave për faljen e 100 euro për tatimpaguesit e komunës së Shtimes, për vitin 2023

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Sqaroi se unë nuk kam qenë që ta kemi një mbledhje të Jashtëzakonshme, duke pas parasysh bazën ligjore. Ne e kemi pa të arsyeshme që ta mbajmë një mbledhje të rregullt. Prandaj e hapi diskutimin.

**z.Kadri Emini;** Ne është mirë me dërguar vetëm një Rekomandim, sepse ata vendosin (Ministria).

**z.Përparim Ramusa;** Unë jam pro që të ti rekomandojmë Kuvendit por mendoj se nuk ka qenë nevoja me u ngrit fare kjo çështje.

**znj.Adelina Beqaj;** E përkrahu edhe unë, sepse po bëhet fjalë për ngarkesën që u bëhet qytetarëve.

**\* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Rekomandimit për Ministrinë e Financave për faljen e 100 euro për tatimpaguesit e komunës së Shtimes, për vitin 2023.**

Pasi diskutime të tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 10:52h.

Procesmbajtësi  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF  
Adnan Ademi